



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TROPOJE
KESHILLI BASHKIAK

Nr. 4952/1 Prot

Bajram Curri me 31/12 2020

V E N D I M

Nr.166, Date 24.12.2020

“MBI MIRATIMIN E KALENDARIT TE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM
2021-2023 DHE BUXHETIT VJETOR 2021”.

Këshilli i Bashkisë Tropojë në mbledhjen e tij të datës 24.12.2020, me propozimin e kryetarit të bashkisë, në mbështetje të nenit 8 pika 2, neni 9 pika 1/1.1, shkronja “b”, neni 34 pika 6, neni 41 pika 1, neni 54 shkronja “dh” dhe neni 55 pika 3 dhe 6 të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; neni 113 të Ligjit nr.44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; neni 6, 15, 17, 32 dhe 44 i Ligjit nr. 9936, datë 28.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; neni 6, shkronjat “ç” dhe “d”, neni 33, neni 40, neni 41, pika 1 dhe 3 të Ligjit nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”; Ligji nr.10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiarë dhe Kontrollin; Udhëzimit nr.10 datë 27.02.2020 “Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023”; Udhëzimi i MF nr.27 date 10/07/2020 “Për Përgatitjen e Buxhetit Vendor”; Këshilli Bashkiak

V E N D O S I:

1. Te miratoje Kalendarin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023 dhe Buxhetit Vjetor ,2021 si me poshte:



Nr	Aktivitetet e Projekt Buxhetit afatmesem 2021-2023	Personat pergjegjes	Afati
1	Keshilli i Bashkise Tropoje miraton Kalendarin per pregatitjen e PBA-se 2021-2023 dhe Projektbuxhetit Vjetor 2021	Kryetari Bashkise Tropje	Deri me 31 Dhjetor 2021 ¹
2	Pregatitja e raportit vleresues paraprak te te ardhurave per periudhen 2021-2023	Sektori i tatim taksave	Deri me 31 Janar 2021 ¹
3	Miratimi i Raportit te parashikimit te te ardhurave per periudhen 2021-2023	Sektori I tatim taksave	Deri me 1 Mars 2021 ²
4	Pregatitja dhe miratimi ne Keshillin e Bashkise Tropoje te tavanave pregatitore per secilin program buxhetor.	Grupi per Menaxhim strategjik dhe Ekipet e Menazhimit te Programeve	15 Mars 2021 ³
5	Perpilimi i Udhezimit te Brendshem per pregatitjen e PBA-se me tavanet buxhetore te miratuara per cdo program, manualin shpjegues, pasqyrat per plotesim nga EMP-ja per kerkesat buxhetore.	Grupi per Menaxhim strategjik dhe Ekipet e Menazhimit te Programeve, dhe Drejtorite perkatese	20 Mars 2021 ⁴
6	Plotesimi i kerkesave buxhetore te konsoliduara per cdo program, dhe kerkesave shtese sipas programeve nga drejtueit e EMP-ve.	Ekipete e Menaxhimit te Programeve/Drejtorite dhe Sektoret perkate.	25 Mars 2021 ⁵
7	Vleresimi dhe miratimi nga Grupi per Menaxhim strategjik i kerkesave e buxhetore te paraqitur nga Ekipet e Menazhimit te Programeve	Grupi per Menaxhim strategjik dhe Ekipet e Menazhimit te Programeve	15 Maj 2021 ⁶



¹ Jo më vonë se data 31 janar, kryetari i njësise së vetëqeverisjes vendore paraqet për shqyrtim e miratim në keshill raportin për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave „pika 2 e nenit 34 te Ligjit nr 68/2017”Per Financat e Veteqeverisjes Vendore”

² Këshilli i njësise së vetëqeverisjes vendore miraton raportin e vlerësimeve dhe të parashikimeve afatmesme të të ardhurave jo më vonë se data 1 mars, pika 4 e nenit 34 te Ligjit nr 68/2017”Per Financat e Veteqeverisjes Vendore”

³ Këshilli i njësise së vetëqeverisjes vendore miraton tavanet përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm jo më vonë se data 15 mars, pika 6 e nenit 34 te Ligjit nr 68/2017”Per Financat e Veteqeverisjes Vendore”

⁴ Jo më vonë se 5 ditë nga data e miratimit të tavanave përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm,

kryetari i njësise së vetëqeverisjes vendore miraton udhëzimin e përgatitjes së buxhetit të njësise së vetëqeverisjes vendore dhe e shpërndan tek të gjitha njësitet shpenzuese, pika 1 e nenit 35 te Ligjit nr 68/2017”Per Financat e Veteqeverisjes Vendore

⁵c) afatet e përgatitjes së kërkesave të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm pika c e nenit 35 te Ligjit nr 68/2017”Per Financat e Veteqeverisjes Vendore

⁶ afatet e përgatitjes së kërkesave të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm pika c e nenit 35 te Ligjit nr 68/2017”Per Financat e Veteqeverisjes Vendore.

8	Hartimi i Draft-Dokumentit të PBA-se 2021-2023 dhe dergimi në Ministrinë e Financave, sipas formateve të derguara nga Ajo.	Grupi për Menaxhim strategjik dhe Ekipet e Menaxhimit të Programeve dhe Kryetari i Bashkisë	Deri me 1 qershor 2021 ⁷
9	Shqyrtimi i rekomandimeve për Draft PBA-ne dhe përgatitja e një opinioni në lidhje me rekomandimet e MF. Draft i Pba-se, rekomandimi përkatës dhe vlerësimi i rekomandimeve, paraqiten për miratim në keshill	Kryetari i Bashkisë dhe Grupi për Menaxhim Strategjik.	Deri me 30 Qershor 2021 ⁸
10	Projekt Buxheti Afatmesëm 2021-2023 i miratuar dërgohet në mënyrë elektronike dhe zyrtarisht në Ministrinë e Financave	Kryetari i Bashkisë dhe Grupi për Menaxhim Strategjik.	30 Qershor 2021 ⁹
11	Publikimi i Dokumentit të Projekt Buxhetit Afatmesëm 2021-2023, të miratuar	Kryetari i Bashkisë dhe Grupi për Menaxhim Strategjik.	5 Korrik 2021 ¹⁰
12	Miratimi në Keshillin e Bashkisë të tavanëve përfundimtarë të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm në nivel programi	Kryetari i Bashkisë dhe Grupi për Menaxhim Strategjik.	20 Korrik 2021 ¹¹
13	Udhëzim i brendshëm, me tavanet përfundimtarë të shpenzimeve në nivel programi dhe fatet e përgatitjes së kërkesave të rishikuara të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm	Kryetari i Bashkisë dhe Grupi për Menaxhim Strategjik.	25 Korrik 2021 ¹²
14	Finalizimi i dokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023 i rishikuar dhe publikimi i tij	Kryetari i Bashkisë dhe Grupi për Menaxhim Strategjik.	Gusht 2021 ¹³
15	Degjësata Publike në lidhje me Projekt Buxhetin afatmesëm 2021-2023	Kryetari i Bashkisë	Gusht-Shtator 2021 ¹⁴

⁷ Brenda datës 1 qershor, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore i dërgon Ministrisë së Financave projekt-dokumentin e programit buxhetor afatmesëm. pika 6 e nenit 36 të Ligjit nr 68/2017 "Per Financat e Veteqeverisjes Vendore"

⁸ Brenda datës 30 qershor, keshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore shqyrton dhe miraton projektin e parë të programit buxhetor afatmesëm, duke shprehur edhe opinionin e tij për rekomandimet e Ministrisë së Financave. pika 8 e nenit 36 të Ligjit nr 68/2017 "Per Financat e Veteqeverisjes Vendore"

⁹ Po aty pika 8, neni 36

¹⁰ Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore merr masat e nevojshme për publikimin e dokumentit të parë të programit buxhetor afatmesëm të miratuar, brenda datës 5 korrik. pika 9 e nenit 36 të Ligjit nr 68/2017 "Per Financat e Veteqeverisjes Vendore"

¹¹ Keshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore miraton tavanet përfundimtarë të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm brenda datës 20 korrik. pika 1 e nenit 37 të Ligjit nr 68/2017 "Per Financat e Veteqeverisjes Vendore"

¹² Jo më vonë se 5 ditë pas miratimit të tavanëve të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore nxjerr udhëzimin plotësues për përgatitjen e buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe e shpërndan tek të gjitha njësitë shpenzuese. pika 2 e nenit 37 të Ligjit nr 68/2017 "Per Financat e Veteqeverisjes Vendore"

¹³ Pas marrjes së udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore nis menjëherë punën për përgatitjen e projektit të rishikuar të programit buxhetor afatmesëm. pika 1 e nenit 38 të Ligjit nr 68/2017 "Per Financat e Veteqeverisjes Vendore"

¹⁴ Pas finalizimit të projektit të dokumentit të programit buxhetor afatmesëm të rishikuar, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore merr masa për publikimin e tij dhe më pas organizon seanca dëgjimore me komunitetin dhe grupet e interesit. pika 2 e nenit 38 të Ligjit nr 68/2017 "Per Financat e Veteqeverisjes Vendore"



16	Bashkia Tropoje dergon ne ne Ministrine e Financave Dokumentin e Programit Buxhetor Afatmesem te rishikuar,te miratuar nga Keshilli I Bashkise,se bashku me nje informacion mbi rekomandimet e dhena nga Ministria e Financave gjate fazes se pare te hartimit te PBA-se.	Kryetari i Bashkise dhe Grupi per Menaxhim Strategjik.	15 Shtator 2021 ¹⁵
17	Zhvillimi i seancave te konsultimit publik dhe reflektimi i sugjetimeve ne Dokumentin Final te PBA-se	Grupi per Menaxhim strategjik dhe Ekipet e Menazhimit te Programeve dhe Kryetari i Bashkise	5 Tetor 2021 ¹⁶
18	Pregatitja e Dokumentit final te Projekt Buxhetit afatmesem dhe Projekt Buxhetit vjetor dhe paraqitja per shqyrtim dhe miratim ne Keshill.	Kryetari i Bashkise	30 Nentor 2021 ¹⁷
19	Miratimi i Dokumentit te Projekt Buxhetit Afatmesem 2021-2023 ,perfundimater dheProjekt Buxhetit Vjetor 2021	Keshilli i Bashkise Tropoje	25 Dhjetor 2021 ¹⁸
20	Publikimi i dokumentit te Projekt Buxhetit Afatmesem 2021-2023 ,perfundimater dheProjekt Buxhetit Vjetor 2021	Kryetari i Bashkise	31 Dhjetor 2021 ¹⁹

1. Per zbatimin e ketij Vendimi ngarkohen,Kryetari i Bashkise, Grupi per Menaxhim Strategjik dhe Ekipet e Menazhimit te Programeve te Bashkise Tropoje
2. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
Ergent GJONGECAJ



KRYETAR KESHILLI
Shotë BASHAJ



¹⁵ . Brenda datës 15 shtator, njësia e vetëqeverisjes vendore dërgon në Ministrinë e Financave dokumentin e programit buxhetor afatmesëm të rishikuar, të miratuar nga këshilli i njësisë, së bashku me një informacion mbi rekomandimet e dhëna nga Ministria e Financave gjatë fazës së pare . pika 3 e nenit 38 te Ligjit nr 68/2017”Per Financat e Veteqeverisjes Vendore”

¹⁶ Ministria e Financave zhvillon seanca konsultimi me njësitë e vetëqeverisjes vendore brenda datës 5 tetor . , pika 4 e nenit 38 te Ligjit nr 68/2017”Per Financat e Veteqeverisjes Vendore

¹⁷ Pas marrjes së mendimeve përfundimtare nga Ministria e Financave dhe bashkërendimit me projektbuxhetin vjetor, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit projektin e programit buxhetor afatmesëm përfundimtar dhe e paraqet për shqyrtim e miratim në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, së bashku me projektbuxhetin vjetor, jo më vonë se data 30 nëntor e vitit buxhetor , pika 1 e nenit 39 te Ligjit nr 68/2017”Per Financat e Veteqeverisjes Vendore”

¹⁸ Projekti i programit buxhetor afatmesëm përfundimtar miratohet nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore, jo më vonë se data 25 dhjetor. , pika 2 e nenit 39 te Ligjit nr 68/2017”Per Financat e Veteqeverisjes Vendore

¹⁹ Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore merr masa për të publikuar dokumentin e plotë të programit buxhetor afatmesëm, përfshirë dokumentacionin shoqërues të tyre, jo më vonë se data 31 dhjetor. , pika 3 e nenit 39 te Ligjit nr 68/2017”Per Financat e Veteqeverisjes Vendore